

Vendim nr. 148 datë 06.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 06.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 26 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ARBEN VEIZAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 18, datë 18.02.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 108, datë 26.10.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2022-1740, datë 22.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 31, 32, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 4 i protokollit 7 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Fier, në datën 11.03.2011 ka regjistruar procedimin penal nr. 152 për veprën penale “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”, të parashikuar nga neni 114/a, pikat 2 dhe 6, të Kodit Penal (KP), mbi bazën e të dhënave të përftuara gjatë hetimit të procedimit penal nr. 75/2011, në kuadër të të cilit, me anë të mjeteve të përgjimit dhe të vëzhgimit, është marrë njoftim se shtetasja T.L. dhe dy djemtë e saj, si dhe shtetasit Arben Veizaj, M.O. dhe M.F. kryenin aktivitetin kriminal të rekrutimit të femrave, me qëllim shfrytëzimin për prostitucion. Në datën 14.03.2011 këta shtetas janë arrestuar në flagrancë si persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i femrave” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 114/b dhe 25 i KP-së.

2. Duke qenë se kjo çështje është bërë konflikt kompetence midis prokurorive, me vendimin nr. 23, datë 31.01.2014 Prokurori i Përgjithshëm ka caktuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda si prokuroria kompetente, e cila në datën 10.02.2014 ka regjistruar procedimin penal nr. 53/2014 në ngarkim të kërkuesit dhe disa shtetasve të tjerë.

3. Në datën 13.02.2014 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka ndryshuar akuzën ndaj kërkuesit nga “Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese” në bashkëpunim në “Trafikim i të miturve” kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 128/b, paragrafi 3, i KP-së dhe më pas ai është akuzuar edhe për veprën penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, të parashikuar nga neni 189, paragrafi 2, i KP-së.

4. Me vendimin e datës 27.11.2014, prokuroria e ka dërguar këtë çështje në gjyq dhe në përfundim të gjykimit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 18, datë 18.02.2016, ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale “Trafikim i të miturve” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 128/b, paragrafi 3 dhe “Falsifikim i pasaportës” parashikuar nga neni 189/2 i KP-së dhe sipas nenit 55 të KP-së për bashkimin e dënimeve ka caktuar një dënim të vetëm me 15 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi.

5. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 108, datë 26.10.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 18, datë 18.02.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2022-1740, datë 22.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se asnjë nga pretendimet

e parashtruara në të nuk i referohet shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

6. Me kërkesën e datës 24.04.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkuesi** ka pretenduar, në mënyrë të përmblodhur, se i është cenuar e drejta për proces të rregullt, në drejtim të:

- 7.1. *Së drejtës për mbrojtje efektive*, pasi në seancën gjyqësore të datës 30.06.2015 avokatët e zgjedhur prej kërkuetit nuk janë paraqitur, edhe pse kanë pasur dijeni rregullisht dhe kjo seancë është zhvilluar në mungesë të tij, duke iu caktuar nga gjykata një avokat kryesisht, pa marrë konfirmimin e kërkuetit. Gjykata e ka lajmëruar kërkuetin nëpërmjet fletëthirrjes, e cila është firmosur nga bashkëshortja e tij, por pa u specifikuar që ai duhet të zgjidhte një avokat tjetër dhe se gjykata i kishte caktuar një avokat kryesisht. Ky lajmërim nuk është efektiv dhe ka ndikuar në mbarëvajtjen e procesit.
- 7.2. *Standardit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi në seancën e parë të zhvilluar në gjykatën e apelit ka marrë pjesë në trupin gjykues një gjyqtar, i cili ka dhënë masën e sigurimit për kërkuetin. Në seancën e radhës ky gjyqtar është ndryshuar pa u dhënë asnjë arsye se përse është larguar nga trupi gjykues, ndërkohë që përfshirja e një gjyqtari të ri në trupin gjykues duhet bërë sipas rregullave procedurale. Në dosjen gjyqësore nuk ka asnjë sqarim se si është zgjedhur anëtar i ri i trupit gjykues dhe nëse është përzgjedhur me short rastësor, qoftë elektronik ose manual.
- 7.3. *Standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit*, pasi gjykata e shkallës së parë dhe e apelit nuk kanë analizuar dhe nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit të kërkuetit në lidhje me institutin e heqjes dorë nga vepra penale të parashikuara në nenin 24 të KP-së. Rekursi është paraqitur fillimisht në mënyrë të përmblodhur, pa u njohur me vendimin e arsyetuar të gjykatës së apelit, me qëllim respektimin e afatit ligjor dhe më pas kërkuesi ka paraqitur shtesën e tij. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij nuk e ka përmendur këtë fakt dhe nuk i ka analizuar shkaqet e paraqitura në rekursin shtesë. Po kështu, sipas

lajmërimin në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, seanca gjyqësore ka qenë e parashikuar 5 minuta përpara përfundimit të orarit zyrtar, ndërkohë që bëhet fjalë për një dosje tepër voluminoze, me një numër të lartë të pandehurish, ndaj kjo kohë ka qenë e pamjaftueshme për gjykatën. Ky fakt tregon se vendimmarrja e asaj gjykate ka qenë e paravendosur. Nga ana tjetër, në procesverbalin e seancës të mbajtur në dhomën e këshillimit nuk është shënuar ora e zhvillimit të seancës dhe ai është një procesverbal tepër formal, që nuk ka asnjë të dhënë që anëtarët e trupit gjykues janë njohur me relacionin e kësaj çështjeje dhe kanë dhënë mendimin e tyre. Ky mospasqyrim korrekt i të dhënave në procesverbal krijon idenë se vendimmarrja ka qenë formale, e paracaktuar dhe e paragjykuar.

7.4. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi faktet e pranuar si të vërtetuara nga gjykata se të pandehurit e kanë shfrytëzuar shtetasen E.T. për prostitucion nuk kanë ndodhur. Referuar materialeve hetimore, veçanërisht atyre të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, arrihet në përfundimin se në lidhje me pretendimet e të dëmtuarës S.T. se është shfrytëzuar për prostitucion nga kërkuesi dhe shtetasi V.M., nuk ka asnjë provë ose indicje që të provojë ekzistencën e faktit penal. Duke i pranuar si të vërteta këto fakte, pa u bazuar në fakte të provuara tashmë, gjykatat kanë paragjykuar çështjen e kërkuesit. Po kështu, në shumë pjesë të vendimeve gjyqësore përmbajtja e përgjigjeve ose thënieve të së dëmtuarës janë tjetërsuar, duke argumentuar dukshëm në të kundërt të asaj që është shkruar në to.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes

së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kolegji thekson se kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është vendosur dënimi i tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve ligjore efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për sa më lart, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjykimit të zakonshëm. Vendimi i fundit që kundërshtohet është ai i Gjykatës së Lartë, ndaj dhe kërkuesi nuk ka mjet tjetër ankimi përveç ankimit kushtetues individual.

13. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi më i fundit që ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuesi është ai Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i datës 22.12.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 24.04.2023. Sipas nenit 15 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, kur afati mbaron në ditë pushimi ose feste, ai shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës ose jofestive. Data 22.04.2022 në të cilën ka përfunduar afati ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues ka qenë ditë e shtunë, për rrjedhojë afati është shtyrë në ditën e parë të punës pasardhëse, pra më 24.04.2023. Në këto kushte, konsiderohet se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive, standardit të gjykatës së caktuar me ligj, standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit, si dhe parimit të

prezumimit të pafajësisë, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, për rrjedhojë do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për mbrojtje efektive

15. Kërkuesi ka pretenduar se në seancën gjyqësore të datës 30.06.2015, të zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, avokatët e zgjedhur prej tij nuk janë paraqitur edhe pse kanë pasur dijeni rregullisht. Kjo seancë është zhvilluar në mungesë të kërkuesit dhe gjykata i ka caktuar një avokat kryesisht pa marrë konfirmimin e tij. Gjykata e ka lajmëruar kërkuesin nëpërmjet fletëthirrjes, e cila është firmosur nga bashkëshortja, por pa u specifikuar që ai duhet të zgjidhte një avokat tjetër dhe se gjykata i kishte caktuar një avokat kryesisht. Sipas tij, ky lajmërim nuk është efektiv dhe ka ndikuar në mbarëvajtjen e procesit.

16. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në veçanti për procesin penal, shkronja “ç” e nenit 31 të Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtje falas kur nuk ka mjete të mjaftueshme.

17. Gjykata ka theksuar se një nga kriteret e gjykimit të drejtë është edhe e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t’u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, e drejtë e cila nuk humbet edhe pse personi i akuzuar penalisht nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t’i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar barazinë e armëve. Në çdo rast, synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Veçanërisht në procesin penal, mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës

dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimin nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Caktimi i mbrojtësit në procesin penal, në kushtet dhe mënyrat e parashikuara në ligj, përfshirë dhe atë të caktuar kryesisht nga gjykata, nuk ka për qëllim vetëm pjesëmarrjen e tij në një shkallë të gjykimit, por ndjekjen e çështjes nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së ankimit dhe pjesëmarrjes në të, deri në instancën më të lartë gjyqësore, për të mbrojtur plotësisht të drejtat e të pandehurit në një proces të rregullt ligjor. Veprimtaria e mbrojtësit në kuadër të skemave të ofruara nga shteti ushtrohet duke përmbushur njëkohësisht edhe detyrimet që ai ka në bazë të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij të fundit, avokati ka detyrimin t’i sigurojë çdo klienti që përfaqëson mbrojtje profesionale, të drejtë dhe efektive në funksion të realizimit me besnikëri të interesave të tij, të veprojë me profesionalizëm, besnikëri, ndershmëri dhe dinjitet, të udhëhiqet nga interesat e klientit, si dhe të garantojë mbrojtje ose përfaqësim transparent në interesin më të mirë të klientit që përfaqëson (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 40, datë 06.07.2016; nr. 30, datë 17.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Kolegji, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, vëren se kërkuesi është njoftuar rregullisht për zhvillimin e procesit penal ndaj tij dhe në të gjitha shkallët e gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është përfaqësuar, fillimisht nga mbrojtësja e zgjedhur prej tij me prokurë të posaçme dhe më pas nga mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata, të cilët kanë qenë të pranishëm në seancat gjyqësore të zhvilluara ku kanë mbrojtur interesat e tij.

20. Kolegji vëren se në seancën e datës 18.06.2015, të zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, avokati A.P., i zgjedhur prej kërkuesit, nuk është paraqitur (*shih faqet 96-97 të dosjes gjyqësore*). Në seancën gjyqësore të datës 30.06.2015, të zhvilluar në po atë gjykatë, nuk janë paraqitur as kërkuesi, as avokati i caktuar prej tij. Ashtu si edhe në seancën e kaluar gjyqësore avokati nuk ka qenë i pranishëm dhe është njoftuar me fletëthirrje, e cila i është dërguar në adresën e dhënë nga vetë ai. Gjykata, bazuar në nenin 342/2 të KPP-së, ka ndërprerë seancën gjyqësore dhe ka vendosur shtyrjen e saj për në datën 09.07.2015, me qëllim që të mundësonte praninë e kërkuesit në gjykim (*shih faqet 98-99 të dosjes gjyqësore*).

21. Me shkresën nr. 31/181, datë 30.06.2015, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda i është drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë për të siguruar njoftimin e kërkuesit për seancën gjyqësore të datës 09.07.2015, bazuar në nenet 33/4, 132/2 dhe 140 të KPP-së. Me shkresën nr. 109/282 prot., datë 07.07.2015 Drejtoria e Policisë së Qarkut, Komisariati i Policisë Vlorë, ka sqaruar gjykatën se njoftimi është bërë në banesën e të pandehurit (kërkuesit) nga ndihmësspecialisti i zonës dhe se fletëthirrja është firmosur nga bashkëshortja e tij, duke i bashkëlidhur shkresës edhe këtë fletëthirrje.

22. Kolegji vëren se edhe në seancat e tjera vijuese të zhvilluara në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, përkatësisht ato të datave 09.07.2015, 22.07.2015, 29.07.2015, 14.09.2015 dhe 29.09.2015, kërkuesi nuk është paraqitur dhe gjykata, pasi ka deklaruar mungesën e vullnetshme të tij në gjykim, ka vijuar me përfaqësimin nga mbrojtësi i caktuar kryesisht prej saj (*shih faqet 100-110 të dosjes gjyqësore*).

23. Në seancën gjyqësore të datës 12.10.2015 gjykimi ka vijuar në mungesë të kërkuesit dhe në prani të mbrojtëses së caktuar kryesisht, e cila i ka drejtuar pyetje dëshmitares, si dhe është shprehur në lidhje me kërkesën e prokurorit për të kundërshtuar pjesërisht këtë dëshmi (*shih faqet 260-265 të dosjes gjyqësore*). Edhe në seancën gjyqësore të datës 29.10.2015, e zhvilluar sërish në mungesë të kërkuesit, mbrojtësja e caktuar kryesisht ka qenë e pranishme dhe ka kundërshtuar kërkesën e prokurorit për shtyrjen e seancës, pasi kjo përbënte shkak për zvarritjen e shqyrtimit gjyqësor (*shih faqet 305-308 të dosjes gjyqësore*). Në seancën gjyqësore të datës 16.11.2015 kërkuesi ka qenë i pranishëm dhe ajo është shtyrë nga gjykata me kërkesë të tij, me qëllim që t'i jepte mundësinë të zgjidhte vetë një mbrojtës (*shih faqet 547-549 të dosjes gjyqësore*). Në seancën gjyqësore të datës 23.11.2015 është paraqitur në gjykim si përfaqësuese e kërkuesit avokatja O.M., sipas prokurës së posaçme nr. 3709 rep., nr. 1565/2 kol., datë 16.11.2015, e cila rezulton të ketë përfaqësuar kërkuesin edhe në seancat e tjera gjyqësore në atë gjykatë. Në seancën gjyqësore të datës 18.02.2016, në të cilën është shpallur vendimi, kërkuesi dhe mbrojtësja e zgjedhur prej tij kanë qenë të pranishëm dhe kanë kërkuar para gjykatës deklarimin e tij të pafajshëm për veprat penale për të cilat akuzohej.

24. Kolegji, duke pasur parasysh faktet si më sipër, të cilat merren në analizë për të verifikuar respektimin e së drejtës për mbrojtje efektive gjatë procesit gjyqësor, vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka marrë të gjitha masat për njoftimin e kërkuesit për zhvillimin e seancave gjyqësore dhe se ai ka qenë i pranishëm gjatë procesit, duke iu dhënë mundësia që të sigurojë edhe mbrojtjen me avokat të zgjedhur personalisht.

Caktimi i mbrojtësit kryesisht është realizuar nga gjykata vetëm pasi ajo ka konstatuar mungesën e avokatit të zgjedhur prej kërkuesit dhe pasi ka shtyrë disa herë seancat gjyqësore me qëllimin e marrjes së të gjitha masave për të siguruar praninë në to të atij mbrojtësi. Nga ana tjetër, edhe kërkuesi nuk ka argumentuar se pse mbrojtja ka qenë joefektive dhe çfarë pasojash konkrete kanë ardhur në dëm të interesave të tij.

25. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të gjykatës së caktuar me ligj

26. Kërkuesi ka pretenduar se në seancën e parë të zhvilluar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda ka marrë pjesë në trupin gjykues një gjyqtar që ka dhënë masën e sigurimit ndaj tij. Në seancën e radhës ky gjyqtar është ndryshuar pa u dhënë asnjë arsye se përse është larguar nga trupi gjykues, ndërkohë që përfshirja e një gjyqtari të ri në trupin gjykues duhet bërë sipas rregullave procedurale. Në dosjen gjyqësore nuk ka asnjë sqarim se si është zgjedhur anëtar i ri i trupit gjykues dhe nëse është përzgjedhur me short rastësor, qoftë elektronik ose manual.

27. Gjkata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Ky parim në jurisprudencën kushtetuese është trajtuar i lidhur me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi, të cilat duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre, gjatë një procesi të zhvilluar sipas një procedure ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. Gjithashtu, këtë parim Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 6, datë 02.03.2018; nr. 15, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Kolegji, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, vëren se sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 01.04.2016 në trupin gjykues të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda ka qenë edhe gjyqtari G.B. Kjo seancë gjyqësore është shtyrë për efekt të njoftimit të

mbrojtësve të caktuar gjatë saj dhe për t'iu lënë një afat i arsyeshëm për t'u njohur me aktet dhe provat, me qëllim realizimin e një mbrojtjeje efektive (*shih faqen 415 të dosjes gjyqësore*). Në datën 14.04.2016, gjyqtari G.B. ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, pasi nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale ka konstatuar se gjatë fazës së hetimit paraprak ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e palëve, përfshi edhe ato për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal për kërkuesin. Kjo kërkesë është pranuar nga Kryetari i gjykatës, i cili, me urdhrin nr. 150, datë 15.04.2016, ka urdhëruar “*hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale nr. 43 akti për zëvendësimin e gjyqtarit G.B., short i cili do realizohet në datën 15.04.2016...*”. Sipas këtij shorti gjyqtari G.B. është zëvendësuar me gjyqtaren N.D., e cila në seancën gjyqësore të datës 15.04.2016 ka qenë pjesë e trupit gjykues dhe palët janë njohur me të (*shih faqet 428-430 të dosjes gjyqësore*).

29. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se largimi i gjyqtarit B.G. nga trupi gjykues dhe zëvendësimi i tij me gjyqtaren N.D. është bërë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, dhe palët kanë marrë dijeni për këtë fakt duke mos paraqitur gjatë gjykimit asnjë pretendim për këtë zëvendësim të gjyqtarëve.

30. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të gjykatës së caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit

31. Sipas kërkuesit, gjykata e shkallës së parë dhe e apelit nuk kanë analizuar dhe nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit të tij në lidhje me institutin e heqjes dorë nga vepra penale. Rekursi është paraqitur fillimisht në mënyrë të përmbledhur, pa u njohur me vendimin e arsyetuar të gjykatës së apelit, me qëllim respektimin e afatit ligjor dhe më pas kërkuesi ka paraqitur shtesën e tij. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij nuk e ka përmendur këtë fakt dhe nuk i ka analizuar shkaqet e paraqitura në rekursin shtesë. Po kështu, sipas lajmërimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, seanca gjyqësore ka qenë e parashikuar për t'u zhvilluar 5 minuta përpara përfundimit të orarit zyrtar, ndërkohë që bëhet fjalë për një dosje tepër voluminoze, me një numër të lartë të pandehurish, ndaj kjo kohë ka qenë e pamjaftueshme për atë gjykatë. Ky fakt tregon se vendimarrja e saj ka qenë e paravendosur. Nga ana tjetër, në procesverbalin e seancës të mbajtur në dhomën e këshillimit nuk është shënuar ora e zhvillimit të seancës dhe ai është një procesverbal tepër formal, që nuk ka asnjë

të dhënë që anëtarët e trupit gjykues janë njohur me relacionin e kësaj çështjeje dhe kanë dhënë mendimin e tyre. Ky mospasqyrim korrekt i të dhënave në procesverbal krijon, gjithashtu, idenë se vendimmarrja ka qenë formale, e paracaktuar dhe e paragjykuar.

32. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, si dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur, ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 23, datë 29.04.2021; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është edhe e drejta e aksesit në gjykatë. Gjykata është shprehur se në rastet kur kërkuesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimi të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe e drejta e ankimit, në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 56, datë 25.07.2017; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Kolegji vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara në rekursin e kërkuesit Arben Veizaj, ka vlerësuar se asnjë nga pretendimet e ngritura nuk i referohet shkaqeve të rekursit të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas atij kolegji, në rekurs janë ngritur pretendime në drejtim të vlerësimit të

fakteve dhe të provave, duke u kundërshtuar provueshmëria e akuzës në ngarkim të kërkuarit, dhe nuk janë argumentuar shkelje të ligjit material ose procedural nga gjykata e apelit. Në lidhje me pretendimet për vlerësimin e fakteve dhe provave, Kolegji Penal ka vlerësuar se ato qëndrojnë jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Në lidhje me pretendimin për kualifikimin e gabuar ligjor të akuzës për të cilën është deklaruar fajtor kërkuari, referuar moshës së të dëmtuarës, ai ka vlerësuar se ky pretendim ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykata e apelit, e cila, në lidhje me verifikimin e moshës së të dëmtuarës, ka riçelur hetimin gjyqësor duke vlerësuar edhe një herë faktin e qenies së të dëmtuarës në moshë të mitur, fakt ky që përligj kualifikimin ligjor të akuzës sipas nenit 128/b të KP-së *(shih paragrafët 27-28 të vendimit të Kolegjit Penal)*.

35. Ndërsa në lidhje me pretendimin e kërkuarit se gjykatat e zakonshme nuk kanë analizuar dhe nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit për institutin e heqjes dorë nga vepra penale, sipas nenit 24 të KP-së, Kolegji vlerëson se ky pretendim ka natyrë ligjore dhe, për më tepër, kërkuari nuk ka arritur të argumentojë pasojën konkrete në drejtim të së drejtës kushtetuese procedurale ose substanciale për proces të rregullt. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara nga kërkuari në lidhje me orarin e caktuar për zhvillimin e seancës gjyqësore dhe kohën e pamjaftueshme për shqyrtimin e çështjes së tij, si edhe përmbajtjen e procesverbalit gjyqësor të seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë, ato nuk janë të tilla që të vënë në dyshim cenimin e së drejtës së aksesit. Nga ana tjetër, lidhur me pretendimin se Kolegji Penal nuk ka evidentuar në vendim shtesën e rekursit formalisht, mospasqyrimi i kësaj shtese, sipas Kolegjit, nuk cenon kriteret kushtetuese të arsyetimit, për sa kohë që pretendimet e tij janë listuar në vendim dhe ndërkohë kërkuari nuk ka argumentuar se cilat kanë qenë shkaqet e reja të kësaj shtese të rekursit dhe nëse ato kanë qenë të natyrës kushtetuese.

36. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke proceduar në dhomën e këshillimit, ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuari, duke i verifikuar ato në funksion të aksesit në gjykatë dhe arsyetimi i atij vendimi, edhe pse është vendosur mospranimi rekursit, nuk cenon standardet kushtetuese. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit është haptazi i pabazuar.

D. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë

37. Kërkuesi ka pretenduar se faktet e pranuar si të vërtetuara nga gjykata se të pandehurit e kanë shfrytëzuar shtetasen E.T. për prostitucion nuk kanë ndodhur. Referuar materialeve hetimore, veçanërisht atyre të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, arrihet në përfundimin se në lidhje me pretendimet e të dëmtuarës S.T. se është shfrytëzuar për prostitucion nga kërkuesi dhe shtetasi V.M., nuk ka asnjë provë ose indicje që të provojë ekzistencën e faktit penal. Duke i pranuar si të vërteta këto fakte, pa u bazuar në fakte të provuara tashmë, gjykatat kanë paragjykuar çështjen e kërkuesit. Sipas tij, në shumë pjesë të vendimeve gjyqësore përmbajtja e përgjigjeve ose thënieve të së dëmtuarës janë tjetërsuar, duke argumentuar dukshëm në të kundërt të asaj që është shkruar në to.

38. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën e Gjykatës është pranuar se parimi i prezumimit të pafajësisë ka kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 13, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Kolegji, referuar standardeve të mësipërme, vëren se nga përmbajtja e vendimeve objekt kërkese, nuk rezulton që gjykatat të kenë nisur procesin me paragjykimin dhe prezumimin se kërkuesi është fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat është gjykuar. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda rezulton se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar prova dhe janë pyetur një sërë dëshmitarësh dhe në të janë dhënë arsyet se përse gjykata ka arritur në përfundimin se kërkuesi është i përfshirë në këtë veprimtari kriminale. Ajo gjykatë e ka deklaruar fajtor kërkuesin pasi nga sa ka rezultuar në gjykim është provuar kryerja e veprës penale për të cilën ai akuzohet dhe pasi ka krijuar bindjen për fajësinë e tij (*shih faqen 44 të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda*). Po ashtu, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka arritur në të njëjtin përfundim si gjykata e shkallës së parë, duke analizuar dhe vlerësuar të gjitha pretendimet e kërkuesit, si dhe provat në ngarkim të tij.

40. Për sa më sipër, Kolegji çmon se gjykatat e kanë deklaruar fajtor kërkuesin mbi një sërë provash të administruara në gjykim dhe të shqyrtuara e vlerësuara prej tyre në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën dhe nuk rezulton që ato të kenë arritur në një konkluzion *apriori* për fajësinë e tij. Për rrjedhojë, edhe pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

41. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.